



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:217499

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05486285

**P.nr.288/22**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit M.Z, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1986/2022 të datës 20.10.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **07.02.2024**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj dhe të pandehurit M.Z, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 01.03.2024, përpiloi, këtë:

## A K T G J Y K I M

### I pandehuri:

**M.Z**, nga i ati D.dhe e ëma E.e gjinisë D., i lindur me datë ... në fshatin S., ku edhe banon rr. "Guri i Vogël" nr.65, Komuna I., i martuar, babai i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet ne liri.

## ËSHTË FAJTOR

### Sepse:

Me datë 01.09.2022, rreth orës 13:00, në fshatin S.Komuna I., në vendin e ashtu quajtur Guri i Lmut, Rajonin Ekonomiko Pyjor Mokna, me qëllim të vjedhjes pret 40 copa trungje me vëllim prej 4,80 m<sup>3</sup>, në dëm të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi Komuna Istog, në atë mënyrë që i pandehuri në vendin e lartcekur me motosharrë pret 40 trungje të llojit të bungut, me diametër 12-23cm, me lartësi prej 8-11m, me vëllim të përgjithshëm prej 4.80m<sup>3</sup>, të cilat me pas i ngarkon në traktor, por që haset nga pylltarët, e si pasojë e kësaj të dëmtuarës i shkakton dëmin në vlerë prej 614 euro.

- me çka ka kryer veprën penale **vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40,43, 46, 47, 48, 49, 69 të KPRK-së dhe nenin 242, 364 dhe 369 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i shqipton:

## DËNIM GJOBË

- I. Ashtu që, të pandehurit **M.Z.**, i shqiptohet dënimi më gjobë në shumën prej katërqind (400) euro, *i cili dënim do te jetë më kusht, nuk do të ekzekutohet* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
  - **Në të kundërtën**, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me gjobë, ashtu që, do të shqiptohet dënimi për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.
- II. Të pandehurit, i shqiptohet edhe **dënim plotësueses, urdhër për kompensimin e dëmit**, të cilin dëm e ka shkaktuar me kryerjen e veprës penale të lartcekur, **ashtu që: URDHËROHET** i pandehuri **M.Z.**, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në afat prej 15 ditësh, **të dëmtuarës Komuna Istog**, të i'a kompensoj dëmin e shkaktuar në shumë prej **gjashtëqind e katërmbëdhjetë (614) euro**, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.
- III. **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. **Pala e dëmtuar: Komuna Istog**, *nuk udhëzohet në kontest civil.*

## A r s y e t i m

### Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1986/2022 të datës 20.10.2022, kundër të pandehurit M.Z, për shkak të veprës vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 3, nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 07.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj dhe i pandehuri M.Z, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

**I pandehuri M.Z** ka deklaruar: se e pranon fajësinë për shkak të veprës penale për të cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se pendohem për këto veprime për të cilat akuzohet, drunjët i ka shfrytëzuar për nevoja personale dhe nuk i kam pasur për shitje.

**Prokurori i Shtetit**, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë, te deklaruar nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet, një pranim i tillë u bë në mënyrë vullnetare dhe gjënë mbështetje të plotë ne provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjithashtu i propozoj gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit të shikoj ne evidencat penale se ne rast që këtu i pandehuri ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë tjetër penale, ndërsa rrethana lehtësuese të marrë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

#### Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve të lartcekura si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale të lartcekur për të cilën është akuzuar.

#### Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata duke vepruar konform nenit 359 par.2 të KPP-së, pas shqyrtimit të gjitha provave ne të cilat është mbështetur aktakuza, pas analizimit të përshkrimit faktik të aktakuzës, dhe pas pranimit të gjitha veprimeve të cilat përshkruhen ne përshkrimin faktik të aktakuzës nga i pandehuri konform nenit 242 par.3 të KPP-së. Ka konstatuar se i pandehuri me veprimet inkriminuese të përshkruara nga prokuroria në përshkrimin faktik të veprës penale, i ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale *vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së*. Sepse, nga përshkrimi faktik i veprës penale, nuk rezulton se i pandehuri sasinë e trungjeve të prerë, i ka prerë në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm sepse prokuroria nuk ka theksuar se Rajoni Ekonomiko Pyjor Mokna është pyll apo park i mbrojtur apo ka ndonjë destinim të posaçëm, Gjithashtu nga shkresat e lëndës nuk rezulton se prokuroria ka bashkangjitur prova se vërtetojnë se vendi ku i pandehuri ka kryer veprën penale, është: pyll i mbrojtur, park i mbrojtur apo pyll tjetër me destinim të posaçëm siç përcaktohet, siç përcaktohet në nenin 349 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së. Prandaj, ky ndryshim i

kualifikimit juridik nga vepra penale *vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3, nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së*, në veprën penale *vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së*, bëhet i domosdoshëm, ngase një ri – cilësim i tillë i veprës penale është edhe konform përshkrimit faktik të kësaj vepre penale, provave ne te cilat mbështetet akuza, rrjedhimisht mbi këto fakte dhe dispozita ligjore gjykata bëri rikualifikimin e kësaj vepre penale e cila është edhe me e favorshe për të pandehurin, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes se kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

#### Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe rrethanat personale se është penduar për këto veprime; ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur se i pandehuri ka qenë i dënuar edhe me parë me aktgjykim të formës së prerë në çështjen penale me numër të SMIL-it 2022:086166. Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 te KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë në shumën prej katërqind (400) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, me te cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Gjykata, të pandehurit me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me gjobë i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen veprë tjetër penale gjatë periudhës kohore të verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

#### Vendimi për dënimin plotësues

Gjykata duke vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 59 par.1, 2 nënpar.2.2 dhe nenit 61 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptoi dënimin plotësues urdhrin për kompensimin e dëmit të shkaktuar me kryerjen e veprës penale, për faktin se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka rezultuar se shumica e dëmit e cila i është shkaktuar të dëmtuarës ka qenë e përcaktuar në tërësi si dhe i pandehuri nuk e ka kontestuar shumën e dëmit me rastin e deklaramit për fajësinë.

#### Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj shumën prej 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

#### Vendimi për kërkesat pasurore-juridike

Pala e dëmtuar, nuk u udhëzua në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, meqenëse Gjykata me dënimin plotësues si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e ka urdhëruar që palës së dëmtuar t'i bëhet në tersi kompensimi i dëmit të shkaktuar nga i pandehuri me veprë penale. Si dhe pala e dëmtuar nuk kishte ndonjë kërkesë tjetër pasurore.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**Procesmbajtësja  
Hale Ahmetaj**

**GJYQTARI  
Petrit Nrecaj**

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*